

# Nënkryetarët e Komunave për Komunitete (NKKK) 2019

Nënkryetari i Komunës për Komunitete (NKKK) është mekanizëm lokal i mbrojtjes i detyrueshëm në komuna ku komunitetet në pakicë numerike përbëjnë të paktën dhjetë përqind të popullsisë së komunës. Me vendim të kuvendit komunal, mund të krijohet edhe në komuna ku popullsia e komuniteteve në pakicë numerike nuk e arrin pragun prej dhjetë përqind. NKKK është i mandatuar për të dhënë këshilla dhe udhëzime për kryetarin e komunës për çështjet që lidhen me komunitetet dhe duhet të përfaqësojë të gjitha komunitetet që banojnë në komunë. Kandidati për NKKK propozohet nga kryetari i komunës dhe miratohet nga kuvendi komunal. Dokumentet kryesore që rregullojnë krijimin dhe funksionimin e NKKK-ve janë Ligji për vetëqeverisjen lokale, (Nr. 03 / L-040, 2008), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Udhëzimi Administrativ nr. 01/2014 mbi procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna dhe termat e referencës për NKKK-të.

## Themelimi

NKKK është themeluar në 14 nga 38 komuna:

<i>Dragash</i>	<i>Ferizaj</i>
<i>Fushë Kosovë</i>	<i>Graçanicë*</i>
<i>Kamenicë</i>	<i>Kllokot</i>
<i>Lipjan</i>	<i>Mamushë</i>
<i>Novobërdë</i>	<i>Obiliq</i>
<i>Prizren</i>	<i>Shtërpçë</i>
<i>Zubin Potok**</i>	<i>Zveçan**</i>


Shkronjat e pjerrëta tregojnë se në cilat komuna NKKK-të janë të detyrueshëm sipas regjistrimit të popullatës.

\* Në Graçanicë, posti ishte bosh gjatë periudhës së raportimit, megjithëse është i detyrueshëm. Nuk pasqyrohet në diagramët e këtij dokumenti.


\*\*Shifrat e popullsisë së këtyre komunave ishin të paqarta pasi nuk u mbajt regjistrimi i popullatës në to.

Të gjitha gjetjet në këtë grup të të dhënave bazohen në monitorimin e rregullt të ekipeve në terren dhe rishikimet specifike periodike, si dhe raportet e prodhuara nga komuna.

## Lidhja e NKKK-se me komunitetet



## Përbërja gjinore e NKKK-ve\*




\* Tri komuna me NKKK gra janë Kllokoti, Mamusha dhe Prizreni


## Numri i NKKK-ve që ndërmarrin detyra të përcaktuara nga korniza ligjore dhe e politikave

Sigurimi i këshillave dhe udhëzimeve për Kryetarin e Komunës rreth çështjeve të komuniteteve


Po  
Jo




Mbështetja e kërkesave të komuniteteve për organet komunale




Zhvillimi i komunikimit me komunitetet dhe/ose promovimi i aktiviteteve të kontaktimit nga komuna




Sigurimi që ekzekutivi komunal zbaton në mënyrë efektive projekte, aktivitete, politika dhe rregullore që lidhen me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve




Promovimi i dialogut ndërmjet komuniteteve



Promovimi i ndërtimit të besimit ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve komunale



Të sigurohet që janë paraparë fonde të mjaftueshme në buxhet për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe që nevojat dhe interesat e komuniteteve të merren parasyh gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit.



Misioni i OSBE-së në Kosovë mbështet përmirësimin e pjesëmarrjes së komuniteteve në proceset dhe institucionet publike vendimmarrëse dhe qeverisëse. Për të ndihmuar në këtë përpjekje, Misioni i OSBE-së në Kosovë rregullisht monitoron punën e mekanizmave komunalë të mbrojtjes së komuniteteve. Këto fletë informative synojnë të sigurojnë për aktorët përkatës komunalë dhe institucionet qeveritare, tregues që mund të ndihmojnë në identifikimin e boshllëqeve dhe përmirësimin e pajtueshmërisë.

# Zëvendëskryesuesit e Kuvendeve Komunale për Komunitete (ZKKKK) 2019

Zëvendëskryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete është mekanizëm lokal i mbrojtjes i detyrueshëm kur komunitetet përbëjnë të paktën 10 përqind të popullsisë së komunës. Është i mandatuar për të shqyrtuar të gjitha ankesat nga pjesëtarët e komuniteteve në lidhje me shkeljet e të drejtave të tyre përmes akteve ose vendimeve të kuvendit komunal dhe është përgjegjës për referimin e shkeljeve të tilla në kuvendin komunal. ZKKKK mund të kërkojë rishikimin e aktit ose vendimit përkatës. Për më tepër, në rrethana specifike, ZKKKK mund të dorëzojë aktet ose vendimet, që konsiderohen se shkelin një të drejtë të garantuar me kushtetutë, në Gjykatën Kushtetuese. Kjo pozitë nuk mund të themelohet në komuna ku popullsia e komuniteteve në pakicë numerike nuk e arrin pragun prej dhjetë përqind, dhe postin e mban anëtar i komunitetit i cili ka marr më së shumti vota nga lista e hapur e kandidatëve për zgjedhjet komunale. Dokumentet kryesore që rregullojnë krijimin dhe mandatin e ZKKKK-së janë Ligji për vetëqeverisjen lokale (Nr. 03 / L-040, 2008) dhe Udhëzimet për zëvendëskryesuesin e kuvendit komunal për komunitete.

## Themelimi


ZKKKK është krijuar në 10 nga 38 komuna:

Dragash	Fushë Kosovë*
Graçanicë	Klllokot
Mitrovicë Veriore**	Novobërdë
Prizren	Shtërpcë
Zubin Potok**	Zveçan**

\*Ndonëse ishte e detyrueshme në Fushë Kosovë, komuna nuk e emëroi askënd në këtë pozitë. Kjo komunë nuk përfaqësohet në diagramët shoqërues.

\*\*Paqartësi në lidhje me krijimin e pozitës për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare të regjistrimit të popullatës për këto komuna.

## Lidhja e ZKKKK-së me komunitetet




## Përbërja gjinore e ZKKKK-ve

Gjatë periudhës së raportimit, të gjithë ZKKKK-të ishin burra.


## Numri i ZKKKK-ve që ndërmarrin detyra siç përcaktohet nga legjislacioni

(Bazuar në monitorimin e ekipeve në terren rishikimet specifike periodike nga ekipet në terren, si dhe raportet e prodhuara nga komunat)



\*\*\* Hapi tjetër për ndonjë nga rastet e tilla do të ishte që ZKKKK t'ia referojë çështjen kuvendit komunal për rishikimin e aktit ose vendimit. Nëse kuvendi komunal zgjedh të mos rishikojë aktin ose vendimin e tij ose ZKKKK konsideron se, edhe pas rishikimit, akti ose vendimi paraqet shkelje të një të drejte të garantuar me kushtetutë, atëherë ZKKKK e referon çështjen drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese.

## Funksionimi & Raportimi



ZKKKK të cilët kanë hartuar plan pune.

ZKKKK-të të cilët kanë hartuar raport zyrtar periodik për Kuvendin Komunal.